



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE

Mj. Ad. Pojan  
- Drg. Tek. Inj. Publik ✓  
02.07.2020  
*[Signature]*

Nr.528/1862 Akti

Korce ne date 29.06.2020

**"NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE"**  
(Per njoftimin e seances pargatitore)

**Drejtuar per afishim:** Ne kendin e afishimit prane Njesise Administrative Pojan

**Per shtetasin/shtetasen:** Palen e paditur Irfan Lici i biri i Saliut, banues ne Orman.

Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është paraqitur kërkesepadia qe i perket:

**PADITES:** Zyra Permbarimore Korce

**TE PADITUR:** Irfan Liçi, Adriana Liçi, Dhimitrula Liçi

**OBJEKTI:** Kerkohet vecimi dhe pjestimi i pasurise se paluajtshme ne bashkepronesi te shtetasit debitor Irfan Lici.

**BAZA LIGJORE:** Neni 578 e vijues i K.Pr.Civile.

Ne kuader te veprimeve paraprake per njoftimin e padise, akteve dhe kerkeses "Per Leshimin e Deklarates se Mbrojtjes", nuk eshte siguruar komunikimi efektiv me palen e paditur per shkak se referuar te dhenave te sistemit T.I.M-s prej dates 04.04.2017 ju si pale e paditur ndodheshit zyrtarisht jashte territorit te republikes se Shqiperise, fakt i konfirmuar dhe nje Njesia Administrative Pojan.

Gjykata pasi ezauroi etapat procedurale per njoftimin Tuaj sipas neneve 129-133 te K.Pr.Civile, si me siper, vendosi te procedoje me njoftimin nepermjet shpalljes publike, bazuar ne nenet 133/a dhe 133/b, te K.Pr.Civile, duke u afishur nje kopje e shpalljes prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe, si gjykata ku gjykohet mosmarreveshja, nje kopje prane Njesise Administrative Pojan ku ndodhet vendbanimi Juaj, nje kopje ne deren e baneses Tuaj te fundit zyrtare brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe ne faqen zyrtare te gjykates.

*Nepermjet ketij njoftimi me shpallje date 18.02.2020 Ju kemi bere me dije se jeni thirrur ne cilesine e te paditurit ne kete proces gjyqesor dhe prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe, zyres se Gjyqtares Sonjela Voskopi mund te gjeni nje kopje te kerkesepadise, akteve shoqeruese dhe kerkeses per leshimin e "Deklarates se mbrojtjes".*

*Deklaraten e mbrojtjes mund t'a paraqisni me afat maksimal brenda 30 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme e perfundimit te afati 20 (njezet) ditor te afishimit te shpalljes prej se ciles keni marre dijeni, ne te kundert e humbisni kete te drejte.*

Deri ne daten 27.06.2020 juve si pale e paditur nuk keni depozituar nje te tille. Gjykata ne llogaritjen e afateve ka marre ne konsiderate pezullimi e tyre sipas V.K.M-se nr.9, date 25.03.2020 dhe rifillimin e ecjes se tyre aty ku ishin nderprere, pas nxjerrjes se V.K.M-se nr. 21, date 27.05.2020.

*Nr. 87 Prot  
Dt. 02.07.2020*